



# KOMUNA E MALISHEVËS



# BULETINI

Nr. 79- Janar- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - [www.malisheva-komuna.org](http://www.malisheva-komuna.org)



Më të mirët e vitit 2009, në lëmi të ndryshme



## **Përmbajtja:**

|                                                                                                            |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Shpallen më të mirët në sport, kulturë dhe rini, për vitin 2009.....                                       | 3  |
| Konstituohet Asambleja Komunale e Malishevës.....                                                          | 4  |
| Mbahet takimi i fundit i Këshillit të Drejtorëve me përbërjen e vjetër .....                               | 6  |
| Mbi 10 mijë euro tejkalohet planifikimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë për vitin 2009 .....               | 7  |
| Kryetari Kilaj priti në takim komandanti i BSHJ-së, Hofmeyer.....                                          | 8  |
| Çdo e enjte nga ora 10:00 – 12:00, do të jet pritje e palëve nga kryetari i Komunës .....                  | 9  |
| Zgjidhet kryesuesi i Asamblesë Komunale të Malishevës, emërohet zëvendëskryetari dhe formohet qeveria..... | 10 |
| Kryetari Kilaj kërkon punë, angazhim dhe menaxhim të detyrave.....                                         | 11 |
| Kryetari Kilaj mbajti takimin e rregullt javor me qytetarët .....                                          | 12 |
| Japin betimin edhe 13 këshilltar komunal .....                                                             | 12 |

## Shpallen më të mirët në sport, kulturë dhe rini, për vitin 2009

### Malishevë, 6 janar

Sot, janë shpallur, më të mirët në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit. Në këtë ceremoni solemne, Kryetari i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj, pasi përshëndeti të gjithë fituesit, tha: “Shpalljen e më të mirëve për vitin 2010, do ta bëjmë në ambientet sportive apo kulturore, pasi brenda këtij viti do të përfundojnë dy projektet më kapitale, Shtëpia e Kulturës dhe Palestra Sportive”.

Në aktivitetin e organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, drejtori Rexhep Mazreku, pasi uroi të gjithë të shpërblyerit, se kjo Drejtoria, i ka realizuar të gjitha detyrat e saja, sipas planprogramit të saj, dhe cilësoi si vit të suksesshëm.

Më të dalluarit për vitin 2009 janë:

Në sektorin e sportit:

Adelina Javori- hendbolliste më e mirë, Arbnorë Berisha- atletja më e mirë, Ismet Morina- post mortum, Mendurim Hoti- futbollist i vitit dhe shpresa e së ardhmes, Valdrin Bacaliu- futbollist më i mirë, Ardiana Mazreku- futbollistja më e mirë, Idriz Zogaj- shahisti më i mirë, Blerim Shala- veteran i sportit, nëntë herë kampion i Kosovës në not, Besart Shala- sportist i dekadës, pesë herë kampion dhe tri rekorde në nivel të Republikës së Kosovës, Monika Shurdhaj- notuesja dhe sportistja më e mirë e vitit, 3 herë vende të katërta në Stamboll, Veton Telaku- trajner i vitit, KN “Besa” klubi i vitit, Haxhi Berisha- shenjëtari më i mirë, Agim Morina- falënderim për kontributin e dhënë sportit.

Në sektorin i kulturës:

SHKA “Salih e Feriz Krasniqi”, SHKL “Tafil Kelmendi”, GL “Fan Noli” Shkolla e Mesme Profesionale Ekonomike-Juridike, e Kijevës, GL “Hamdi berisha” Gjymnazi i Malishevës, Devotshmëri Krasniqi – SHFMU “Visar Krasniqi”, Verë Mazreku SHFMU “Ibrahim Mazreku”.

Në sektori i bibliotekës lexuesit më të dalluar :

Selman Mazreku, Albana Morina, Liridon Sopaj, Antoneta Paçarizi, Erion Paçarizi, Miranda Javori, Kaltrina Toplana, Albin Gashi.

Nga sektori i rinisë janë shpërblyer :

Këshilli i Veprimtari Rinorë Lokal, HANDIKOS-i, Këshilli i Prindërve dhe Arsimitarëve – Malishevë, Isa Ulluri- Qendra Rinore.



tha  
e

## Konstituohet Asambleja Komunale e Malishevës

### Malishevë, 8 janar



Sot, në sallën e mbledhjeve, është bërë konstituimi i Asamblesë Komunale të Malishevës, ku kanë dhënë betimin e tyre anëtarët e zgjedhur me votat e qytetarëve, në zgjedhjet e 15 Nëntorit. Po ashtu edhe Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka dhënë betimin për kryetar komune, gjithashtu i zgjedhur drejtpërdrejtë nga votat e qytetarëve.

Mbledhja e sotme inauguruese, është hapur nga Kryetari i Komunës, ndërsa vazhdimin e mbledhjes dhe procedurat e

betimit i ka udhëhequr këshilltari më i vjetër, z.Ragip Begaj.

Betimin e kanë dhënë, 19 nga 31 këshilltarët, sa i ka Asambleja Komunale e Malishevës.

Betimi i Kryetarit të Komunës dhe i asamblistëve është bërë në bazë të Kushtetutës së Kosovës, Ligjit mbi Qeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Malishevës.

Në vazhdim fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, me rastin e dhënies së betimit dhe inaugurimit për kryetar në periudhën 2010-2014.

Të nderuar këshilltarë, të nderuar familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale, përfaqësues të KFOR-it, të nderuar mysafir, të gjithë Ju që jeni prezent në mbledhjen solemne ku po themelojmë Kuvendin e Ri me këshilltarët dhe kryetarin e zgjedhur në zgjedhjet lokale, Nëntor - Dhjetor 2009. Mirëserdhët!



Ju lutem të pranishmeve që të më lejoni, që nga kjo foltore të shpreh falënderimet e mia të përzemërta të gjithë aktivistëve, anëtarëve dhe simpatizantëve të Partisë Demokratike për besimin e dhënë fuqishëm për kandidaturën time dhe të subjektit në zgjedhjet që na e përcaktuan pozitën tonë. Dua të falënderoj gjithashtu të gjithë qytetarët apo thënë ndryshe të gjithë simpatizantët e partive tjera që me mbështetën me votën e tyre, që na e dhanë besimin, dua të përsëndes dhe të falënderoj të gjitha subjektet tjera politike si LDK, AAK, LDD, për qëndrimin e tyre në zgjedhje, për një fushatë dhe zgjedhje dinjitoze në Komunën tonë të dashur dhe martire Malishevën. Përsëndetje për partinë Aleanca Kosova e Re për Koalicionin me PDK-ne dhe kontributin e dhënë në fitoren tonë dhe në zgjedhje

përgjithësisht.

Të nderuar pjesëmarrës, sot kam rastin gjithashtu të falënderoj të gjithë qytetarët që erdhën dhe më uruan për zgjedhjet dhe zgjedhjen time për kryetar. Të falënderoj përfaqësuesit e partive politike dhe qytetarët e shumtë që më uruan. Në mënyrë të veçantë të falënderoj Fetah Rudin nga rivalët politik, i cili nga të parët me uron për zgjedhje, dhe të gjithë ata që nga largësia më uruan dhe, të tillë ishin mijëra e mijëra qytetarë.

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës, në zgjedhjet e 13 Dhjetorit fitoi Demokracia në Malishevë, fituan qytetarët e Komunës së Malishevës. Besimi i dhënë, kaq fuqishëm nga Ju, vetvetiu krijon një obligim të jashtëzakonshëm për mua. Askush më shumë se unë nuk do ketë vullnet, dëshirë, ambicie, angazhim që të kemi sukses në qeverisjen katërvjeçare. Unë u siguroj se gjithë energjia ime pozitive, përvoja dhe profesionalizmi im do të shfrytëzohen maksimalisht që Malisheva jonë e dashur të arrij hapin me komunat e zhvilluara në Republikën e Kosovës. Tashmë kemi siguruar bazën e një zhvillimi të tillë. Malisheva po bëhet me rrugë gjithandej fshatrave të saja, me rrjete kanalizimi e ujësjellësi, me Pallat Sporti e Shtëpi Kulture, me Qendër Shkollore Profesionale të nivelit evropian, me fermer të suksesshëm, e me biznese të mëdha, me administratë profesionale, shërbime mjekësore 24 orë, me përkujdesje të veçantë

për familje të dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve, të njerëzve me nevoja të veçanta. Në këto katër vite ne do ti kushtojmë një vëmendje të veçantë zhvillimit ekonomik, punësimit dhe atë përmes stimulimeve në prodhimtari, në bujqësi dhe turizëm. Investime të mëdha do të bëhen në mbrojtjen e ambientit, në sport dhe kulturë. Ngritja e kushteve në shkolla me kabinete dhe infrastrukturë tjetër, është një fushë e veçantë por e përhershme e jona në prioritet.

Edhe administrata do të freskohet dhe rikonfigurohet, gjatë kësaj kohe, në mënyrë që të kemi disiplinë të shtuar përgjegjësi në punë dhe shërbime profesionale në të mirë të qytetarëve.

Unë do të siguroj komunikim të rregullt me përfaqësues të fshatrave dhe kryesitë e tyre. Një ditë në javë do ta rezervoj për takime me qytetarë, për të parë nevojat dhe kërkesat e tyre.

Çdo vit do të sigurojmë ndihmë në ndërtimin e pesë shtëpive për kategoritë e veçanta dhe ndihmë të përhershme për të gjithë të varfrit për t'ju siguruar ushqim dhe medikamente falas.

Të nderuar Këshilltarë të të gjitha partive Politike; tanimë unë përfaqësoj të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës dhe për të realizuar synimet tona për një Malishevë të zhvilluar kërkoj mbështetjen Tuaj gjatë katër viteve që i kemi përpara. Unë do kërkoja që për vendimet me interes të përgjithshëm të kemi edhe pajtim të përgjithshëm, të të gjitha grupeve parlamentare. Opozita të luaj një rol konstruktiv si opozitë e cila do të më ndihmoj mua që të kemi vendime parimore, të drejta dhe objektive. Edhe opozita të gëzohet dhe mbështes punët e mira dhe sukseset dhe të ngrit zërin për punët e këqija, për dështimet dhe vendimet e gabuara, unë do jem mbështetës i saj .

Po ashtu, kërkoj nga qytetaret, mbështetje në punën time dhe të Kuvendit, kërkoj mirëkuptim dhe arsyetim për mospërmbyllje të të gjitha nevojave që kanë. Kjo me vetë faktin, se jo gjithçka dhe jo për një kohë të shkurtër, mund të realizohen të gjitha nevojat e qytetarëve. Komuna e Malishevës është një komunë e re dhe e pazhvilluar, me një buxhet të kufizuar. Por jam i sigurt se me punën tonë, me angazhim të përgjithshëm, me mbështetjen e Qeverisë Thaçi, do të arrijmë synimet tona, projektet të cilat do ta sjellin Malishevës në nivel të lartë zhvillimi. Unë besoj!

Ju faleminderit!

## Mbahet takimi i fundit i Këshillit të Drejtorëve me përbërjen e vjetër

### Malishevë, 11 janar

Sot, është mbajtur takimi i fundit i Këshillit të Drejtorëve, me përbërjen e vjetër, pasi në fund të javës, pritet të formohet Qeverisa e re Komunale, me ç'rast do të caktohet edhe numri i drejtorive dhe drejtorëve, në seancën e Asamblesë Komunale që do të mbahet premten.

“Nëse çdo gjë shkon sipas planifikimit, të premten duhet të caktohet numri i drejtorive dhe nga java e ardhshme, duhet të jetë përbërja



të

e



Qeverisë së Re Komunale”, ka thënë Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj.

Me këtë rast kryetari Kilaj, i ka falënderuar të gjithë drejtorëve të drejtorive, për angazhimet e deritanishme dhe raportet e mira, si në aspektin e përgjegjësisë, ashtu edhe në aspektin kolegjal.

“Ka qenë një frymë e mirë dhe kolegjiale, por kjo s’do të thotë se nuk kemi mundur të bëjmë edhe më shumë, dhe qeveria e ardhshme, duhet të bëjë edhe më shumë dhe unë falënderoj për punën e deritanishme”, ju ka thënë kryetari Kilaj, përgjegjësve të drejtorive komunale.

Përveç kësaj, në këtë mbledhje, kryetari ka kërkuar nga drejtorët aktual, që të vazhdojnë me punët nëpër drejtoritë e tyre, ndërsa konkretisht është kërkuar rregullimi i disa gropave në rrugë, që shpije për Kijevë, të shkaktuara nga reshjet e fundit, pastaj të bëhet projekti për rrugën deri tek Shtëpia e Kulturës, të largohen hekurishtet dhe punëtoritë tjera, të ndaluara në vende publike, apo përgjatë rrugëve, largimi i një kioske në afërsi të shkollës në Mleqan dhe i një objekti në afërsi të shkollës në Banjë.

Po ashtu, në këtë mbledhje, kryetari Kilaj, ka kërkuar shqyrtimin e mundësive dhe fillimin e procedurave për largimin e objekteve të vjetra, të pa shfrytëzuara, siç është ish shkolla fillore në Malishevë dhe krijimi i hapësirave të gjelbëruara apo sportive, në vend të tyre. Njëkohësisht është kërkuar mirëmbajtje dhe intervenim në rregullimin e objektit të komunës.

## **Mbi 10 mijë euro tejkalohet planifikimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë për vitin 2009**

### **Malishevë, 12 janar**

Raporti i Zyrës së Tatimit në Pronë, e cila vepron në kuadër të Drejtorisë për Buxhet e Financa, pasqyron shifrën prej mbi 10 mijë euro të hyra më shumë së sa shuma e planifikuar gjatë vitit 2009.

Kjo Drejtori, përkatësisht sektori i Tatimit në Pronë, për vitin 2009, kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 115 mijë euro, ndërsa ka realizuar mbi 125 mijë euro.

Menaxheri i Zyrës së Tatimit në Pronë, në Komunën e Malishevës z.Avni Krasniqi e konsideron sukses inkurajues tejkalimin e grumbullimit të të hyrave, dhe njëkohësisht vlerëson kontributin e qytetarëve ndaj komunës së Malishevës por edhe ndaj shtetit të Kosovës në përgjithësi.

“Zyra e Tatimit në Pronë ka funksionuar në bazë të rregullores Komunale mbi Tatimin në Pronë, por edhe në bazë të rregullores qendrore nr. 2003/29 si dhe udhëzimeve administrative

të nxjerra nga Ministria e Financave për Zyre të Përhershme të Tatimit në Pronë”, ka bërë të ditur z.Krasniqi.

## Kryetari Kilaj priti në takim komandanti i BSHJ-së, Hofmeyer

### Malishevë, 13 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, priti sot në takim, komandantin e Brigadës Shumëkombëshe të Jugut, Gjeneral Brigade, Manfred Hofmeyer. Takimi kishte karakter njohës, si dhe është diskutuar për gjendjen e përgjithshme në komunën e Malishevës.



Fillimisht, kryetari Kilaj, e falënderoi komandantin e BSHJ-së, për bashkëpunimin e shkëlqyer, që kanë pasur deri më tani me KFOR-in, e në veçanti me CIMIC-un gjerman, duke përmendur këtu projekte të realizuara së bashku, në mesin e të cilave ndërtimin i dy shkollave njëra në Guncat e tjetra në Temeçinë, por edhe shumë projekte tjera.

“Ne kemi respekt të veçantë dhe i jemi mirënjohës, KFOR-it në përgjithësi e në veçanti atij gjerman, pasi që vepron në regjionin ku

gjeografikisht është edhe Malisheva si komunë, por i jemi mirënjohës edhe popullit dhe qeverisë gjermane, për gjithë ndihmën e dhënë, për lirinë, ndërtimin dhe zhvillimin e vendit tonë”, tha kryetari Kilaj, duke e falënderuar komandantin gjerman të KFOR-it, gjeneral brigade M. Hofmeyer.

Në anën tjetër gjenerali Hofmeyer, e uroi kryetarin për rizgjedhjen e tij në këtë post dhe uroi që sa më shpejt të konstituohet edhe qeveria komunale dhe të vazhdojnë punët dhe projektet për zhvillimin e Malishevës.

“Shprehi kënaqësinë time për ndryshimet pozitive në aspektin e zhvillimit të Malishevës, pasi, pas dhjetë viteve, po shoh ndryshime të mëdha dhe pozitive”, ka thënë gjenerali Hofmeyer, i cili ishte i njoftuar me Malishevën, edhe në vitet e para të pas lufte.

Kryetari Kilaj dhe gjenerali Hofmeyer, kanë biseduar edhe për çështje të tjera, kryesisht për planet e kryetarit në katër vitet e ardhshme, ndërsa gjenerali uroi për ndërtimin e shkollës së mesme profesionale, si njëri ndër investimet më të mëdha, por edhe më të rëndësishmet për këtë pjesë.

## Çdo e enjte nga ora 10:00 – 12:00, do të jetë pritje e palëve nga kryetari i Komunës

### Malishevë, 14 janar

Duke filluar nga dita e sotme, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, çdo të enjte, nga ora 10:00 – 12:00, do ketë zyrën e hapur për të gjithë qytetarët e Malishevës, në mënyrë që të njihet drejtpërdrejt me hallet dhe problemet e tyre.

Kryetari Kilaj, sot ka pritur 23 palë, nga të cilët, përveç urimeve për zgjedhjen e tij kryetar komune, ka dëgjuar hallet që këto palë kishin në jetën e përditshme, problemet sociale dhe nevojat tjera, çoftë individuale apo kolektive.

Kjo mënyrë e komunikimit, do të vazhdojë për katër vitet e ardhshme, dhe do të ketë për qëllim kontaktin e drejtpërdrejt me qytetarët, si dhe evitimin e përditshmërisë që palët kërkojnë takim me kryetarin, ngase një pritje e përditshme është e pamundur, për shkak të obligimeve të tjera që ka kryetari.



*Nga mbledhja e sotme e Kuvendit*

## Zgjidhet kryesuesi i Asamblesë Komunale të Malishevës, emërohet zëvendëskryetari dhe formohet qeveria

### Malishevë, 15 janar

Sot në mbledhjen e dytë të Asamblesë Komunale të Malishevës, me shumicë votash, kryesues i Asamblesë Komunale u zgjodh z.Ragip Begaj, nga radhët e PDK-së, i cili fitoi 17 vota të 19 asamblistëve me të drejtë vote, ndërsa kundërkandidati Hafir Rexha (AKR), fitoi 2 vota.

Po sot, është miratuar edhe numri i drejtorive komunale të propozuara nga kryetari i komunës,



dhe tani qeveria komunale do t'i ketë 11 drejtorë. Ndërsa drejtorët e emëruar, që

do të udhëheqin me këto drejtori janë si në vijim:

1. Administratë e Përgjithshme - Haki Krasniqi
2. Ekonomi, Financa dhe Buxhet - Vesel Krasniqi
3. Urbanizëm - Esat Paçarizi
4. Gjeodezi dhe Kadastër - Nuhi Shala
5. Inspektorat - Besim Dobruna
6. Bujqësi dhe Pylltari - Sinan Kryeziu



7. Shërbime Publike - Alban Kastrati
8. Emergjencë dhe Siguri - Halit Zogaj
9. Arsim dhe Edukim - Isuf Morina
10. Kulturë, Rini dhe Sport - Mevludin Mazreku
11. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Skënder Hoti

Nënkryetar i komunës, nga ana e kryetarit, është emëruar z.Rexhep Mazreku.

Po ashtu në këtë mbledhje, u votua edhe për formimin e dy komiteteve obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komiteti për Komunitete. KPF do të ketë nëntë anëtar, ndërsa ai për komunitete do të ketë pesë anëtar.

*Nga mbledhja e parë e përbërjes së re të Qeverisë Komunale*

## **Kryetari Kilaj kërkon punë, angazhim dhe menaxhim të detyrave**

### **Malishevë, 25 janar**

Në mbledhjen e parë të përbërjes së re të qeverisë komunale, të mbajtur sot, Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, i uroi njëmbëdhjetë drejtorët e drejtorive, në detyrën e re (disa nga të rizgjedhur), duke kërkuar angazhim dhe disiplinë në punë, si dhe menaxhim të mirë të detyrave dhe obligimeve të tyre.

“Të keni planin e punës, të bëni raporte mujore, ti mbikëqyrni punëtorët, të respektohet orari i punës dhe të ketë përgjegjësi në punë, nga ana e secilit drejtor për 132 punëtorët e administratës komunale dhe në fund të jepni vlerësimet e juaja për punëtorët”, i ka porositur kryetari Kilaj, drejtorët e Drejtorive.

Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, kërkoi, në veçanti nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, që të menaxhohet mirë shfrytëzimi i veturave zyrtare dhe i karburanteve.

“Duhet përgjegjësi dhe seriozitet, ju jeni të përzgjedhurit e kësaj përbërje dhe kjo qeveri duhet të ketë sukses, dhe për asnjë minutë nuk duhet të mungoj angazhimi dhe puna”, i ka porositur drejtorët, kryetari Kilaj, duke përfunduar fjalën e tij, me besimin e plotë se kjo qeverisje do të ketë sukses. “Besoj në këtë ekip dhe në suksesin që do ta kemi bashkë”, ka përfunduar fjalën e tij.



Në emër të drejtorëve, drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër, Nuhi Shala, si drejtori më i vjetër në moshë, ka falënderuar kryetarin, për besimin e dhënë dhe uroi për bashkëpunim, mes drejtorive drejt suksesit si qeveri komunale.

Të njëjtin urim e bënë edhe drejtorët tjerë dhe nënkryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku.

## Kryetari Kilaj mbajti takimin e rregullt javor me qytetarët

### Malishevë, 28 janar

Si çdo të enjte edhe sot, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka vazhduar me pritjen e palëve dhe takimet e drejtpërdrejta me qytetarët, në zyrën e tij, ku ka pritur rreth 30 palë dhe është njohur me problemet, kërkesat dhe nevojat e tyre, si ato individuale ashtu edhe ato kolektive.

Problemet kryesore të qytetarëve, të cilët janë paraqitur para kryetarit të komunës, kishin të bënin me nevoja të ndryshme, për ç'gjë kryetari Kilaj, ju ka dhënë përgjigje dhe i ka udhëzuar për procedurat që duhet të ndiqen në lidhje me ato kërkesa në drejtim të institucionit të komunës apo edhe për kërkesa tjera në drejtim të institucioneve tjera.

Për disa raste, ku ka pasur mundësi, kryetari ka premtuar ndihmë, siç ishte nevoja urgjente e një familjeje të një pjesëtari të ish UÇK-së nga fshati Guncat, për meremetimin e shtëpisë, pastaj ndërtimi i kanalizimit për 15 familje të një lagjeje në Drenocv, por edhe për raste tjera, ku duhet intervenimi i komunës, apo i kryetarit.

## Japin betimin edhe 13 këshilltar komunal

### Malishevë, 29 janar

Sot, në seancën e radhës, kanë dhënë betimin edhe 13 këshilltar komunal, 12 prej të cilëve nuk e kishin bërë më herët betimin (11 LDK dhe 1 LDD), dhe një këshilltar i ri nga radhët e AAK-së, Fatos Kryeziu, i cili zëvendëson Avni Robajn, pasi ky i fundit ka dhënë dorëheqje.

Në këtë mbledhje grupi i këshilltarëve të PDK-së, e kanë lëshuar këtë lëshuar atë, në shenjë pakënaqësie dhe mos pajtimi me 12 këshilltarët komunal, të cilët kishin bojkotuar dy seancat e para, atë solemne dhe seancën tjetër.

“Si shkak i kësaj, ne nuk mund të jemi prezent, prandaj bëjeni betimin pa prezencën tonë”, tha shefi i grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, Enver Hoti, i cili paraprakisht i përshëndeti për gatishmërinë, 12 këshilltarët e LDK-së dhe LDD-së, që më në fund po e bëjnë betimin e këshilltarit për Kuvendin Komunal.

## Në shënimin e Flakës së Janarit, përkujtohen dëshmorët e Malishevës, të vitit 1990

### Malishevë, 29 janar



Në kuadër të shënimit të manifestimit “Flaka e Janarit”, me një akademie përkujtimore, sot janë përkujtuar dëshmorët e kombit Ali Kryeziu dhe Hisni Mazreku, të vrarë më 30 janar 1990, e njohur si “Masakra e Malishevës”, ndërsa është ndarë edhe çmimi “Dr.Tafil Kelmendi”, pas vdekjes për Abdyl Krasniqin, i cili vdiq një muaj më parë.

Në këtë akademi, për ngjarjen e vitit 1990, ngjarje e cila ka shënuar edhe kundërshtimin e parë institucional

ndaj sistemit të atëhershëm shtetëror, kundër dhunës dhe represionit të pushtetit, mbi popullatën shqiptare.

Në vazhdim fjalimi i Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj:

Malisheve, 29.01.2010

Kryetari Isni Kilaj

Fjalë rasti në 20 vjetorin e rënies së dëshmorëve Ali Kryeziu dhe Hisni Mazrreku

E nderuara familje e Hisni Mazrrekut, e nderuara familje e Ali Kryeziut, të nderuar pjesëmarrës të ngjarjes së dhimbshme por krenare të 30 Janarit 1990 , dhe Ju pjesëmarrës në këtë Akademi



përkujtimore, jam i nderuar që me një fjalë rasti të përkujtojmë sot 20 vjetorin e rënies së dy dëshmoreve, Ali Din Kryeziu dhe Hisni Avdullah Mazrreku, si dhe të plagosurit e asaj ngjarjeje e cila shënoi edhe zyrtarisht rrënimin e ngrehinës së quajtur Jugosllavi dhe fillimin e realizimit të ëndrrës së shqiptarëve të Kosovës për liri dhe pavarësi/Republikën e Kosovës. Lëvizjet e shqiptarëve përkrah popujve tjerë evropian që luftonin për demokraci, vitet 1988,89,90 do të sillnin domosdo zemërimin e pushtuesit dhe zgjodhi Malishevën lridashëse për të kërcënuar dhe shtypur energjinë lridashëse të popullit shqiptarë. Me 30 Janar 1990 soldateske serbe vrau dy demonstrues shqiptar në qendër të Malishevës Hisni Mazrrekun dhe Ali Kryeziun dhe plagosi dhjetëra të tjerë. Kjo ngjarje befasoi edhe dashamirësit e Jugosllavisë titiste, por jo pjesën patriotike të popullit e cila nga këtu mori guxim edhe më të fuqishëm për një organizim edhe më të madh dhe vendosmëri të fuqishme për të organizuar luftën për liri deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës në vitin 1999. Dhe pikërisht kjo urrejtje e popullit u tregua që në ceremonitë mortore që u bënë për dy dëshmoret me pjesëmarrje prej qindra e mijëra qytetarëve nga mbarë Kosova. Kjo mobilizoi masat. Edhe përfaqësuesit e pushtetit në Komunën e Malishevës treguan heroizëm duke mbrojtur popullatën dhe qëndrimin se ishte bërë një masakër në qendër të Malishevës. Ky qëndrim do të hidhëronte qarqet më të larta udhëheqëse në Jugosllavi dhe më pas do të sillte edhe shuarjen e administratës së Komunës së Malishevës. Dhe kjo për vetë faktin se nuk mundi të gjente bashkëpunëtor të cilët do të zbatonin pushtetin e tyre në Malishevën shqiptare. Qytetarët e komunës së Malishevës do të vazhdonin të organizoheshin në parti dhe organizata tjera deri në daljen publike të UCK-së, prej nga do të organizohej lufta e fuqishme dhe Malisheva do të shndërrohej në qendër të luftës dhe rezistencës. Lirinë do ta sillnin edhe 70 dëshmor nga Komuna e Malishevës, 360 martir , qindra të plagosur dhe mbi 2500 luftëtarë të lirisë. Kjo do të realizonte edhe ëndrrën e Hisniut dhe të Aliut, për lirinë e popullit të tyre. Sot Malisheva është krenare me të kaluarën e bijve dhe bijave të saj për luftën e tyre, heroizmin përkushtimin dhe gjakun e derdhur që sollën lirinë e kërkuar ndër shekuj. Malisheva dhe familjet e Aliut dhe Hisniut të jenë krenare me bijtë që patën. Lavdi dëshmorëve të kombit Ali Din Kryeziu dhe Hisni Avdullah Mazrreku. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

Ndërsa në këtë Akademi, ka folur edhe ish Kryetari i Kuvendit Komunal të Malishevës, z.Daut Krasniqi, njeriu, i cili në mënyrë të hapur dhe institucionale, e kishte dënuar ngjarjen dhe kishte kërkuar përgjegjësi penale, për vrasjen e dy shqiptarëve në Malishevë.

“Me 30 Janar 1990, u vranë Ali Din Kryeziu dhe Hisni Mazreku, ndërsa me armë zjarri u plagosën 11 qytetar dhe u maltretuan 4 shqiptar. Udhëheqja e komunës, këtë ngjarje e ka kundërshtuar në mënyrë të hapur, menjëherë kemi dhënë kumtesë zyrtare, duke dënuar krimin ndaj qytetarëve të Malishevës dhe për policët serb kemi kërkuar të përgjigjen si kriminel që kanë shkaktuar këto vrasje. Të gjithë udhëheqësit e Kosovës, i kemi njoftuar me gojë dhe me shkrim, duke kërkuar përgjegjësi, por ata kanë qëndruar indiferent. Kjo ngjarje ka ndikuar në Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, që të ndërroj qasjen dhe shqyrtimin e çështjeve. Kontribut të madh në këtë çështje, përkundër censurës që ka ekzistuar, kanë dhënë edhe gazetarët që kanë raportuar nga Malisheva, të cilët tërë ngjarjen e kanë pasqyruar në gazeta, radio dhe në televizion. Si Kuvend Komunal, kemi bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Qarkut në Prizren, kundër policëve serb” ka thënë mes tjerash ish kryetari i KK, Daut Krasniqi.



Pas këtyre fjalimeve, është ndarë edhe çmimi “Dr.Tafil Kelmendi”, çmim të cilin e ndan Shoqata për kulturë dhe letërsi “Tafil Kelmendi” në Malishevë, dhe ky çmim, postmortum, iu nda Abdyl Krasniqit, kurse paraprakisht, për jetën dhe veprën e A.Krasniqit, foli Izet Shala.

Pas përfundimit të kësaj akademie, janë bërë homazhe, në vendin e rënies së dëshmorëve Ali Kryeziu dhe Hisni Mazreku.